



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 23 qershor 2011, në orën 14:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Sabri Hamiti, Donika Kadaj- Bujupi dhe Amir Ahmeti.

I pranishëm sipas ftesës, ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj.

Munguan: Skënder Hyseni dhe Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati e Fjolla Uka- NDI dhe Driton Selmani e Besnik Ramadani-KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R e n d d i t e:

1. Raportim i ministrit Enver Hoxhaj lidhur me aktivitetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme;

Albin Kurti - E përshëndeti praninë e ministrit dhe mundësinë e tij për të raportuar lidhur me aktivitetet e MPJ- së, rreth njohjeve të reja, punën e misioneve diplomatike jashtë vendit, si dhe për zbatimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, mbështetur në qëndrimin e grupit punues për monitorimin e tij.

Enver Hoxhaj, ministër i MPJ- së prezantimin e tij e filloi përkitazi me procesin e njohjeve të pavarësisë së Kosovës, që në pjesën e dytë të vazhdojë rreth punës së misioneve diplomatike. Ai tha se procesin e përmbylljes së njohjes së pavarësisë së Kosovës e bëjnë kompleks dhe të vështirë tri parakushte kryesore: I pari është mos anëtarësimi i Kosovës në OKB, parakushti i dytë është çështja e njohjeve bilaterale e cila është shumë komplekse për Kosovën dhe parakushti i tretë sipas të cilit pavarësia e Kosovës në shumë vende të botës është kuptuar në forma të ndryshme. Ministri njoftoi se MPJ- a ka hartuar një Strategji për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, e cila do të jetë pjesë përbërëse e Dokumentit për Strategjinë për Politikë të Jashtme, që

pritet të miratohet në muajin shtator. Ky dokument synon të analizojë gjithë situatën rreth njohjeve dhe do të përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë ju shpërnda anëtarëve të Komisionit, pjesa e dytë e dokumentit tha se do të përbëhet nga një analizë për secilin shtet duke përfshirë edhe profilin, qëndrimet e dhëna deri tani veç e veç rreth njohjes së Kosovës dhe pjesa e tretë e Strategjisë do të përfshijë planin e udhëtimeve, konferencave në faza javore, mujore e vjetore. Dokumenti njëkohësisht parasheh formimin e një grupi punues për avokim, ku përveç zëvendëskryeministrit Pacolli parasheh edhe emrat e personaliteteve të tjera, të ambasadorëve dhe të diplomacisë parlamentare, të cilët kanë ndikim të fuqishëm në procesin e njohjeve. Ministri njoftoi se ka pasur takime me 40 ministra të MPJ- së, të vendeve të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën, për të cilat tha se ka obligim zyrtar të mbahen në konfidencë. Po ashtu tha se është bërë një punë mjaft intensive sa i përket njohjes së Kosovës nga Vatikani. Republika e Kosovës në të ardhmen planifikon të ketë një ambasador i cili do të mbulonte tërë kontinentin e Afrikës, të hapet një ambasadë në Amerikën Latine dhe një ambasadë në Australi që do t'i mbulonte edhe vendet e Paqësorit.

Shaip Muja -Kërkoj të informohet se përveç njohurive zyrtare lidhur me angazhimet e zëvendëskryeministrit Pacolli rreth njohjeve, si organizohet në mënyrë më specifike puna me të?

Enver Hoxhaj - Njoftoi se përshkrimi i punëve të zëvendëskryeministrit Pacolli është që të merret me çështjet e njohjeve dhe sjelljen e investimeve në Republikën e Kosovës. Takimet janë të rregullta para vizitave dhe pas realizimit të vizitave. Në kuptim të realizimit të punëve kemi pasur marrëveshje që zëvendëskryeministri Pacolli ta vizitoj Afrikën, ndërsa unë Riadin dhe Amanin, për të kontaktuar me ministrat e jashtëm të këtyre vendeve që të ndikojnë në shtete e caktuara për ta njohur Kosovën. Z. Hoxhaj po ashtu njoftoi se do të realizojë edhe një takim në Bullgari, ku përveç nënshkrimit të disa marrëveshjeve bilaterale, do të bëj përpjekje të gjejë kanale komunikimi me Brazilin.

Sabri Hamiti – E përshëndeti praninë e ministrit në Komision dhe e përgëzoi për lëvizjet dinamike që ka pasur javët e fundit. Politika e Jashtme e Kosovës tha se është e domosdoshme të jetë konsensuale, sidomos në këtë kohë, dhe nuk duhet të ketë shumë qendra të vendosjes nga faktorët institucionalë përgjegjës për këtë veprimtari. Deklaroi se mbështet konfidencialitetin në të gjitha segmentet e politikës së jashtme të Kosovës. Duke u ndërlidhur me prezantimin e ministrit z. Hoxhaj tha se, Amerika Latine pa Spanjën dhe pa Vatikanin nuk funksionon, as nga aspekti kulturor, as nga aspekti politik dhe shtroi pyetjen se çfarë duhet bërë që të kemi një ndikim më aktiv në këtë pjesë të botës. Po ashtu shtroi pyetjen se sa është arritur që të motivohen shtetet e mëdha të Evropës që e kanë njohur Kosovën, që të merren me shtete e BE –së që nuk e kanë njohur Kosovën.

Enver Hoxhaj - Sa i përket adresave të shumta të Politikës së Jashtme tha se zëvendëskryeministri Pacolli, sipas përshkrimit të punës së tij, është i ngarkuar i posaçëm për fushën e njohjeve, ndërsa politika e jashtme është e rregulluar me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi dhe bëj përpjekje maksimale që të koordinohet me zëvendëskryeministrin Pacolli. Po ashtu njoftoi për angazhimet intensive dhe takimet me përfaqësues apostolik të Vatikanit, në disa pjesë të botës që të ndikohet në Vatikanin për ta njohur Kosovën. Sa i përket pesë vendeve të tjera të BE- së, që nuk e kanë njohur Kosovën tha se ne do të nënshkruajmë nesër me ambasadorin e Britanisë së Madhe një marrëveshje bashkëpunimi që të ndikohet në këto pesë vende, përmes formave të ndryshme të avokimit, të cilin projekt do ta jetësoj Këshilli Britanik.

Donika Kadaj Bujupi –Tha se bazuar në prezantimin e ministrit veprimet për procesin e njohjeve nuk po mungojnë, por në raport me pritjet rezultatet po mungojnë, andaj shtroi pyetjen se sa po

arrihet të bashkërendohen veprimet me Presidenten dhe zëvendëskryeministrin e parë, duke pasur parasysh se edhe metodologjia e punës po ndryshon dhe se po krijohet përshtypja sikur ekziston një konflikt në mes të Qeverisë.

Enver Hoxhaj - Ndër të tjera theksoi se nga të kyçurit në procesin e avokimit, ka një koordinim jashtëzakonisht të mirë, znj. Presidente është njoftuar në baza të rregullta, sa herë që është dashur të ketë informata për procesin e njohjes.

Hydajet Hyseni - Në diskutimin e tij lidhur me procesin e njohjeve, shtroi pyetjen se sa ka ndikuar procesi i bisedimeve me Serbinë në ngadalësimin e njohjeve, pastaj angazhimet në politikë të Jashtme nga disa linja ajo e presidentit, zëvendëskryeministrit e ministrit, si dhe diplomacia parlamentare e ndihmojnë, apo ndonjëherë edhe e ndërlikojnë procesin e njohjeve. Ndryshimet kushtetuese, veçanërisht në funksionin e presidentit, a do ta vështirësojë punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Po ashtu ceku se në aspektin e njohjeve diplomacia parlamentare dhe grupet e miqësisë nuk janë shfrytëzuara sa duhet, ngase me një angazhim më të madh do të mund të silllej ndonjë njohje.

Enver Hoxhaj - Duke u ndërlidhur me çështjet e shtruuara shtoi se dialogu është keqpërdorur nga diplomacia serbe dhe nga diplomatët që janë kundër pavarësisë së Kosovës. Nuk përjashtohet mundësia që Serbia edhe pas dialogut do të bëjë përpjekje që Kosovën ta kufizojë dhe ta dëmtojë në ndërtimin e sovranitetit të brendshëm të shtetit të ri dhe në ushtrimin e sovranitetit të jashtëm, që të mos njihet prej shumë vendeve. Lidhur me adresat e shumta të politikës së jashtme tha se nuk mendoj se kemi adresa të shumta në krahasim me shtetet e tjera, ne kemi nevojë edhe për më shumë njerëz dhe për një koordinim edhe më të ngushtë. Diplomacia parlamentare do të ishte një mbështetje e fuqishme për MPJ dhe nga shtatori ne do të dalim me një propozim si ministri që të ndihmohemi përmes diplomacisë parlamentare.

Amir Ahmeti - Shtroi çështjen e organogramit të MPJ- së, në të cilin tha se ekzistojnë departamente për shtetet e NATO-s dhe të Amerikës, ndërsa nuk ekzistojnë departamente për Lindjen e Mesme, për Azinë dhe Oqeaninë, të cilat pastaj do të duhej të ndaheshin në sektorë. Çështje tjetër shtroi ndërmarrjen e iniciativës së MPJ- së për të dërguar të posaçëm në Organizatën e Konferencës Islamike, Ligën Arabe ose në Unionin e shteteve të Azisë Qendrore. Në këtë drejtim shtoi se Shqipëria do të mund të ndihmonte, që në kuadër të delegacionit të saj të përfshijë edhe përfaqësuesin tonë. Këto vende janë me karakter lobues, por edhe me karakter të zhvillimit ekonomik dhe do të mund të sillnin investime. Roli i z. Rexhep Bojës si ambasador në shtetet e Gjirit është i pazëvendësueshëm, por hapja edhe e një ambasade do të mundësonte investime kapitale në vendin tonë.

Enver Hoxhaj -I njoftoi lidhur me angazhimin e të dërguarve të posaçëm dhe bashkëpunimin e mirë me ambasadat e Shqipërisë të pranishme në Lindjen e Mesme dhe në vendet e tjera të botës. Lidhur me organogramin e MPJ –së shtoi se ai do të shqyrtohet, dhe se ekziston ideja që të formohen edhe disa departamente, si ai për Lindjen e Mesme, Amerikën Latine dhe për vendet frankofone. Hapja edhe e një ambasade në vendet e Ligës Arabe shtoi se është çështje e cila duhet të bisedohet së bashku. Ambasada në Riad, me ambasadorin R. Bojën, mund të mbulojë atë pjesë të vendeve.

Albin Kurti - Ndër të tjera tha se përveç kësaj pjese të parë të Strategjisë e cila ju dorëzua sot anëtarëve të Komisionit, ne në mënyrë zyrtare nuk kemi pranuar asnjërin nga dokumentet si:

Strategjinë për avokim, Dokumenti për politikë të jashtme e as Programin për aktivitetet e MPJ- së, të premtuara në takimin e para tre muajve nga ministri. Ai i shtroi disa pyetje lidhur me: numrin e njohjeve që parashihihen të arrihen këtë vit, si MPJ; për ndarjen e roleve në mes të MPJ- së, Presidentes, Kryeministrit, zëvendëskryeministrit Pacolli, zëvendëskryeministres Tahiri, ministrit për integritet evropian, ministrit për diasporë, dhe dy zëvendësministrave për punë të jashtme; për takimin e ministrit Hoxhaj në Luksemburg në shoqërim me UNMIK-un; për rubrikën diplomacia publike dhe ekonomike ueb- faqen e MPJ- së, për të cilën tha se është e zbrazët dhe pa përmbajtje; raportin financiar të fushatës së zëvendëskryeministrit Pacolli; për komunikimin me ambasadat e konsullatat e Kosovës nëpër botë; si do të arrihet konsolidimi administrativ e financiar i ambasadave i paraparë në strategji, pasi që buxheti i MPJ- së është shkurtuar; bazuar në deklaratën e ministrit theksoi se nuk është i bindur që nuk mungon dija dhe analiza dhe po ashtu kapacitetet analitike, hulumtuese e studiuese për punë të jashtme; cilat janë hapat që duhet ndërmarrë për përmirësimin e imazhit të Kosovës, duke e pasur parasysh raportin e Dick Martyt, zgjedhjet e manipuluar, korrupsionin e përhapur që kanë ndikuar dhe e kanë stagnuar njohjen e Kosovës; pse nuk janë ndërmarr hapa deri më tani të cilët ndikojnë në promovimin dhe afirmimin e Kosovës në internet; a janë angazhuar ekip profesionistesh për t'u marrë me afirmimin e Kosovës si shtet dhe për sigurimin e domenit në internet "KS"; çfarë është bërë me paratë e ndara për promovimin e Kosovës jashtë vendit dhënë kompanisë "Saatchi & Saatchi" dhe kërkoi ofrimin e një raporti financiar dhe narrativ për të; a është trajtuar propozimi i Komisionit për përfaqësim reciprok ose të përbashkët me Republikën e Shqipërisë; a e keni z. ministër, Platformën e zëvendëskryeministres Tahiri për dialogun në Bruksel dhe draftin e 6 marrëveshjeve të paralajmëruara për t'u nënshkruar në Bruksel; a ka plane konkrete nga MPJ- a për iniciimin e procedurës për kod të veçantë telefonik të shtetit të Kosovës; si dhe kur do të realizohen detyrat nga raporti i Konferencës së parë të ambasadorëve? Dhe vuri në pah se programi i MPJ- së në ueb- faqe daton nga koha kur është themeluar ministria dhe nuk është përditësuar pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur.

Enver Hoxhaj - Duke u ndërlidhur me pyetjet e kryetarit të Komisionit për numrin e njohjeve theksoi se, mbështetur në dokumentin e hartuar mbi 20 shtete kanë qëndrim pozitiv për Kosovën dhe mbi 50 shtete kanë qëndrim neutral. Njoftoi për detyrat e Presidentes, Kryeministrit, zëvendëskryeministrit Pacolli, zëvendëskryeministres Tahiri, ministrit për integritet evropian, ministrit për diasporë, dhe dy zëvendësministrave për punë të jashtme. Sa i përket pjesëmarrjes në Forumin e Bashkimit Evropian tha se nuk është e vërtetë se më është dhënë fjala nga UNMIK-u, por fjala më është dhënë nga baronesha Ashton, dhe se ka qenë ministër i barabartë si të gjithë ministrat e tjerë të punëve të jashtme që kanë qenë pjesëmarrës në takim. Ai vërtetoi se diplomacia publike e ekonomike në ueb- faqen e MPJ-së nuk ka material. Lidhur me raportin për shpenzimet e z. Pacollit rreth fushatës tha se nuk ka ndonjë informatë. Ambasadorët e Republikës së Kosovës ofrojnë raporte të rregullta javore, mujore e vjetore për aktivitetet e tyre. Sa i përket buxhetit të MPJ- së theksoi se nuk kemi nevojë për më shumë buxhet, por ajo që duhet diskutuar në të ardhmen është çështja e ndërtesave për ambasadë. Ministri njoftoi për këshilltarët e tij dhe funksionin e tyre, e po ashtu edhe për angazhimet e zëvendëskryeministrit i cili merret me çështjen e imazhit të Kosovës. Lidhur me prezantimin e Kosovës në internet njoftoi se ka pasur disa takime në Nju -Jork, që Kosova të merr një sajt "KS", për të cilin më hollësisht do të njoftojë në takimin e radhës. Sa i përket kompanisë "Saatchi & Saatchi", tha se ajo nuk është menaxhuar nga MPJ, dhe se nuk ka ndonjë informatë të saktë lidhur me ato shpenzime, por kjo kompani ka ndihmuar në promovimin e një imazhi të ri e modern për Kosovën. Sa u përket përfaqësimeve tha se ne mund të kemi me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Slloveninë ndoshta edhe me Kroacinë shërbime të përbashkëta konsullore, po jo edhe shërbime të përbashkëta diplomatike mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në fuqi. Ministri njoftoi se Platformën e dialogut e ka parë, ndërsa gjashtë marrëveshjet nuk ka

arritur t'i shih. Kostoja buxhetore e Strategjisë së MPJ- së mund të jetësohet përmes mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit qëndrimit dhe nuk ka shpenzime të tjera shtesë. Lidhur me kodin e veçantë të Telekomit të Kosovës, njoftoi se grupi punues është duke punuar në këtë drejtim dhe pas një qartësimi lidhur me punën e tyre do të jetë i gatshëm të informoj. Njoftoi se nga Konferenca e ambasadorëve planet konkrete të veprimit të cilat kanë dalë, synojnë t'i realizojnë. Lidhur me Programin e MPJ- së tha se synim kryesor i yni është të kemi një strategji për politikë të jashtme që pastaj programi i aktiviteteve të burojë nga strategjia. Po ashtu shtoi se është i nevojshëm një plan afatmesëm pesëvjeçar për politikë të jashtme.

Shaip Muja - Duke u ndërlidhur me pyetjen e kryetarit të Komisionit, pyeti ministrin Hoxhaj se sa ka ndikuar në imazhin e Kosovës raporti i Dick Martyt?

Kryetari konstatoi se Komisioni vendosi që, ky takim për shkak të angazhimeve të ministrit Hoxhaj, të ndërpritet dhe çështjet e mbetura të parapara për diskutim në këtë takim, të diskutohen në takimin e radhës me ministrin Hoxhaj.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti